



**Organizata Jo-qeveritare Emancipimi Civil Ma Ndryshe
EC MA NDRYSHE**

29 korrik 2013, Prizren

KOMUNIKATË PËR MEDIA

Qendra Sportive, nga viti i ardhshëm të ndaloj vendosjen e lojërave

Në kuadër të projektit të monitorimit të punës së ekzekutivit komunal të Prizrenit, EC Ma Ndryshe gjatë javëve të kaluara ka shqyrtuar çështjen e vendosjes së lojërave (Luna Parkut) në oborrin e Qendrës Sportive “Sezai Surroi” në Prizren.

Shqetësimet në lidhje me këtë çështje janë ngritur nga grupet e ndryshme të qytetarëve në kuadër të takimeve që “EC Ma Ndryshe” i ka mbajtur me shtresat e ndryshme të shoqërisë, si pjesë e projektit “Qyteti Gjithpërfshirës – Planifikimi me pjesëmarrje për zhvillim të qëndrueshëm urban në Prizren”. Gratë dhe të moshuarit që jetojnë në lagjet afër Qendrës Sportive janë ankuar se vendosja e lojërave ka prishur qetësinë e banorëve që jetojnë në këtë zonë. Ata kanë bërë të ditur se ndotja akustike vazhdon deri në orët e vona të natës dhe se qytetarët privohen nga përdorimi i hapësirës së gjelbër në këtë qendër.

Duke i marrë për bazë këto shqetësime monitoruesit e EC Ma Ndryshe kanë nisur shqyrtimin e rastit, duke kërkuar shpjegime nga autoritetet komunale dhe menaxhmenti i Qendrës Sportive “Sezair Surroi”, lidhur me procedurat që duhet ndjekur për vendosjen e lojërave.

Autoritetet komunale i janë përgjigjur kërkesës së bërë nga EC Ma Ndryshe brenda afateve ligjore, derisa menaxhmenti i Qendrës Sportive nuk ka ofruar një përgjigje me shkrim, përkundër insistimit të monitoruesve, në lidhje me procedurat për vendosjen e lodrave në oborrin e Qendrës Sportive.

Drejtoria e Shërbimeve Publike duke iu përgjigjur kërkesës së monitoruesve ka bërë të ditur se ajo nuk ka qasje sa i përket vendosjes së lodrave në Qendrën Sportive, “ngase me atë hapësirë menaxhon vetë qendra në fjalë dhe se DSHP nuk ka lëshuar kurrfarë dokumenti për vendosjen e tyre, prandaj dhe nuk kemi kurrfarë përgjegjësie”.

Monitoruesit kanë kontaktuar edhe me menaxherin e Qendrës Sportive përmes postës elektronike dhe telefonit. Menaxheri ka kërkuar kohë për t’u përgjigjur, por asnjëherë nuk e ka bërë këtë në mënyrë të shkruar, as pas pritjes së gjatë. Në bisedën e fundit telefonike ai gojarisht ka thënë se ky është viti i fundit që lodrat vendosen në oborrin e Qendrës Sportive. Ndërkohë kanë kaluar disa javë dhe lojërat janë zhvendosur nga oborri i Qendrës Sportive.

EC Ma Ndryshe konsideron se nevojitet një nivel më i lartë i përgjegjësisë si nga menaxhmenti i QS-së ashtu edhe nga komuna në çështjet që kanë të bëjnë me zhvillimet që ndikojnë në jetën e përditshme të banorëve përreth. Menaxhmenti i QS-së duhet të ketë parasysh se hapësira që menaxhon është publike dhe se interesi publik duhet të dominoj mbi përfitimet momentale financiare të QS-së, sado që të jenë të nevojshme ato për funksionimin normal të QS-së.

Ndërsa DSHP-ja nuk mund të arsyetohet me faktin se nuk ka kurrfarë përgjegjësie në këtë rast për shkak se nuk ka lëshuar leje, por duhet të ushtroj ndikimin e vet, si organ përgjegjës për shërbimet publike, që interesat e qytetarëve të jenë mbi ato të grupeve të caktuara të interesit.

EC Ma Ndryshe rekomandon menaxhmentin e Qendrës Sportive “Sezai Surroi” që të mbaj fjalën e dhënë në komunikimin me monitoruesit dhe të mos lejoj më vendosjen e lodrave, që shkaktojnë pakënaqësi te banorët e lagjeve përreth, për shkak të ndotjes akustike dhe ‘uzurpimit’ të hapësirave të gjelbra.

EC Ma Ndryshe i bën thirrje DSHP-së dhe autoriteteve komunale që të dëgjojnë me vëmendje shqetësimet e qytetarëve dhe të ushtrojnë ndikimin e tyre publik, me qëllim të krijimit të një ambienti më të mirë jetësor për ta, në secilin rast.

EC Ma Ndryshe rekomandon edhe Bordin Mbikëqyrës për menaxhimin e objekteve kulturore dhe sportive në Prizren që të merr parasysh ankesat që shprehen nga qytetarët dhe të mos lejoj vendosjen e lodrave në oborrin e QS-së në vitet e ardhshme.

Projekti i EC Ma Ndryshe për monitorimin e transparencës së ekzekutivit do të vazhdojë të publikojë të gjeturat e monitorimit përmes komunikatave të rregullta dhe përmes ueb-faqes së projektit, ku të gjeturat postohen drejtpërdrejtë nga monitoruesit. Tanimë të gjitha të gjeturat e monitorimit, përfshi komunikatat e rregullta dhe shumë informacione të tjera në lidhje me qeverinë lokale të Prizrenit dhe të Mamushës publikohen në baza të rregullta në ueb-faqen e projektit, www.online-transparency.org.

Ju faleminderit për bashkëpunimin tuaj,

Elmedina Baxhaku, Monitoruese
OJQ EC Ma Ndryshe
Rr. Saraçët, Nr. 5 - Prizren
Rr. Zeki Shulemaja, Nr. 2 - Prishtinë
www.ecmandryshe.org & info@ecmandryshe.org
+381 38 224 967 & +381 29 222 771



British Embassy
Pristina

Projekti “Transparenca online e komunave të Prizrenit dhe Mamushës” prej muajit maj 2013 përkrahet financiarisht nga Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar në Prishtinë.